



DHOMA E AVOKATISE TIRANE  
 ZYRA E AVOKATISE  
 “BENGASI & HYSENI LAW-FIRM” SH.P.K.  
 NIPT M01404048A  
 CEL.0692038352

---

ADRESA : RR “JORDAN MISJA”, PALLATET GENER-2, SHKALLA E-KATI 3, TIRANË

### **LETËR E HAPUR**

**DREJTUAR:** 1. AMBASADES FRANCEZE NE SHQIPERI

Rruga Skënderbej, nr. 14 - AL - 1000 TIRANË / Tel. +355 4 238 9700

2. Ministrise se Drejtesise

**Adresa:** Bulevardi “Zog I – rë”

3. Keshilli i Larte Gjyqesor

**Adresa:** Bulevardi Zogu I, Tiranë 1000 Email: kontakt@klgj.al

4. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

**Adresa:** rruga e Kavajes.

5. MEDIA TELEVIZIVE NE SHQIPERI, PUBLIKE DHE PRIVATE.

***I nderuar z.Ambasador!***

***E nderuar zj.Ministre e Drejtesise!***

***E nderuar zj.Kryetare te Komisionit te Pavarur te Kualifikimi!***

***Te nderuar z,zj.Drejtues te medias se lire!***

Me ane te ketij materiali te pergatitur nga Avokatet e perzgjedhur personalisht nga i pandehuri z.Domart Konjari, duam tju veme ne dijeni Ju, si dhe gjithe opinionin publik mbi shkeljet e Konventes se te Drejtave te Njeriut, shkeljen e Konventave Nderkombetare, shkeljen e te drejtave kushtetuese, shkeljen e te drejtave proceduriale dhe ligjore te kryera si nga ana e

Prokurorise së Posacme Kundra Korupsionit dhe Krimin të Organizuar ne ngritjen e akuzes ashtu edhe nga ana e Gjykates se Posacme Kunder Korupsionit dhe Krimin te Organizuar ne gjykimin e ceshtjes penale ne ngarkim te te pandehurit z.Domart Konjari.

Dje më datë 14.09.2020, Gjykata e Posacme kunder Korupsionit dhe Krimin te Organizuar **dha nje vendim penal te paprecedent**, vendim i cili ka minuar te drejtat themelore te njeriut te cilat kane 25 vite qe jane vendosur ne shtetin tone, vendim i cili na ktheu pas ne kohen famkeqe te diktatures, kohe ku dosjet gjyqesore kopsiteshin pa respektuar asnje garanci te personit te dyshuar dhe vendimet jepeshin formalisht ne zyrat e gjyqtareve pa pranine e personit te mare si te pandehur dhe pa i garantuar atij te drejten thelbesore te mbrojtjes.

Ne kete material, jane parashtruar ne menyre te permbledhur Konkluzionet Perfundimtare te te pandehurit te cilat jane pergatitur nga perfaqesuesit e tij ligjor të zgjedhur prej tij, te cileve nuk iu dha mundesia ligjore procedurale per ti lexuar dhe paraqitur ato gjykates. Pasi **Gjykata në seancën e datës 14.09.2020 ka dhënë një vendim pa praninë e Avokatëve të zgjedhur nga vetë ky i pandehur apo Avokatit të caktuar Kryesisht .**

**Gjithashtu kërkojmë nga Mediat të cilat kanë pasqyruar më datë 14.09.2020 lajmin e dhënies të këtij vendimi të përgënjeshtrojnë lajmet e tyre reth akuzave të reme që kanë fabrikuar në lidhje me akuzën e vrasjes, kjo është një gënjeshtër pasi pranë Organit të Akuzës të Shtetit Shqiptar nuk është regjistruar asnjëherë një akuzë e tillë ndaj Z.Domart Konjari.**

**Shtetasi Domart Konjari, eshte mare si i pandehur dhe eshte akuzuar vetem per veprat penale te “Trafikimit te lendeve norkotike”, “Pastrimi i produkteve te vepres penale” “Organizate kriminale”, te parashikuara nga nenet 283/a/2, 287/a,334/1, “Falsifikimi i leternjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” dhe “Korrupsionit aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike” sipas nenit 331/1, 189, 244 te K.Penal.**

Nqs këto media nuk e përgënjeshtrojnë këtë lajm atëhere jemi të detyruar tu drejtohem organeve përkatëse me një kallëzim penal ndaj tyre.

**Ambasada Franceze duhet të reagojë për këto shkelje të të drejtave themelore të njeriut në dëm të Z.Domart Konjari pasi Shteti Francez e ka pajisur me Statusin e Refugjatit këtë shtetas, dhe si rrjedhojë ka për detyrë ti ofrojë një mbrojtje në bazë të Konventave Ndërkombëtare të përmendur në këtë material.**

Më poshtë po paraqesim dhe Diskutimeve Përfundimtare të mbrojtjes për këtë proces gjyqësor të cilën Gjykata nuk na e dha mundësinë ta paraqesim pranë saj:

- Ne shtetin Francez është nisur procedimi penal dhe është gjykuar shtetasi Domart Konjari **ne mungese të tij dhe ne mungese të një avokati të zgjedhur prej tij**, duke i mohuar kështu një prej të drejtave themelore të Konventes Nderkombetare të të Drejtave të Njeriut.
- Te njëjtin veprim procedural ka kryer edhe autoritetet shqiptare, nga ana e prokurorisë pranë gjykates për krimet e rënda nuk i është komunikuar akuza në ngarkim të të pandehurit Domart Konjari si dhe nga Gjykata e Posacme dt.14.09.2020 i është mohuar të pandehurit dhe avokateve të zgjedhur nga ai e drejta për të paraqitur Konkluzionet Përfundimtare, duke dhënë një vendim fajësie në mungese të tyre.

### **KONSTATIMI I SHKELJEVE TE KRYERA NGA ORGANI I AKUZES:**

Jane një serë shkeljesh të bera nga organi i akuzes e kanë shoqëruar këtë procedim penal që në fillim të rregjistrimit të tij, duke filluar që nga pranimi i kërkesës për “*Ndihme të huaj juridike në fushën penale*” sic e kanë klasifikuar ata kallzimin penal nga autoriteti i huaj Francez për ushtrimin e ndjekjes penale ndaj shtetasit Domart Konjari, që konsistojnë në shkeljen e dispozitave të së drejtës ndërkombetare atë të **Konventes e Gjeneves për Refugjatet e vitin 1951, Konventa Europiane për Transferimit e Procedimit Penal, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu edhe të legjisllacionit të brendshëm si Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, K.Pr.Penale dhe K.Penal** të cilat po i rendisim më poshtë:

- I -

#### **Shkeljet të Konventave ndërkombetare.**

**1. Mospermendjen e përfitimit të statusit të refugjatit për shtetasin Domart Konjari që nga viti 1990 në shtetin Francez dhe shkelja e të drejtave ndërkombetare sic është ajo për “moskthimin e tij” ose “Non-Refoulement”, e drejta kjo e përcaktuar nga Konventa e Gjeneves për Emigrantet e vitit 1951 nëni 33 i saj.**

Ne kallzimin zyrtar të bërë nga Gjykata e Shkallës së Lartë e Rennes me shkresën nr.11/283/0037 dt.13.11.2015 pranë Autoriteteve Gjyqësore Shqiptare përkrahur se : “*Duke marrë parasysh vendimin e marrë në mungesë në datën 13 nëntor 2015 nga Gjykata e Kundravajtjes Penale e Rennes ndaj Domart Konjari me shtetësi Shqiptare*”.

Pra, nga autoriteti i huaj qe ka bere kete kerkese per ushtrim te ndjekjes penale, **nuk eshte bere percaktimi i statusit te jeteses se tij ne shtetin Francez**, gje qe na ben te mendojme qe kjo gje eshte bere me dashakeqesi.

**Me dekretin nr.2011-638 te Ministrise se Jashtme**, Domart Konjarit i eshte dhene Karta e Rezidentit si refugjat Shqiptar dhe Pasaporta si refugjat, fakt ky qe duhet te ishte i njohur nga Drejtesia Franceze dhe duhet te saktesohej ne vendimin e dhene nga Gjykata. Konkretisht ai eshte i pajisur me Pasaporte per refugjatin ne emer te tij leshuar nga shteti Francez me Nr.12AH71418.

**Duke qene se kemi te bejme me nje shtetas i cili eshte me Statusin e Refugjatit dhe ka perfituar karten e Rezidentit ne shtetin Francez, atehere ne kete gjykim duhen analizuar dispozitat e te drejtes nderkombetare per refugjatet dhe mundesia e fillimit ose jo te nje procedimi penal ne vendin e “braktisur” sic eshte Shqiperia per Domart Konjarin, nga i cili ka perfituar mbrojtje te posacme ne shtetin e huaj.**

Ne rastin konkret statusi i refugjatit eshte percaktuar ne Konventen e **Gjenevës per Refugjatet e vitit 1951, ku Shqipëria është anëtarë e kesaj Konventës në vitin 1961.**

Konventa e përcakton refugjatin si *“një individ që është jashtë vendit të tij të kombësisë ose vendbanimit të zakonshëm i cili nuk është në gjëndje ose nuk duan të kthehen për shkak të frikës së bazuar të persekutimit në bazë të tij ose saj racës, fesë, kombësisë, mendimit politik apo anëtarësisë në një grup të veçantë shoqëror”*.

Konventa është akt i detyrueshëm për shtetet anëtare. Vendet që kanë ratifikuar Konventën e Refugjatëve janë të detyruar të mbrojnë refugjatët që janë në territorin e tyre, në përputhje me kushtet e saj.

Një nga parimet bazë ku mbështetet procedura e azilit është ai i *Mos-kthimit*. Ishte Konventa e Gjenevës e vitit 1951 ajo e cila parashikoi Parimin e *Mos-Kthimit: i cili ndalon dëbimin apo kthimin e refugjatëve të një vendi në një territor apo vend tjetër ku jeta apo liria e tyre do të ishin në rrezik*.

Neni 33 e Konventës së 1951 ndër të tjera parashikon se: *“1. Asnjë shtet palë nuk do të dëbojë ose kthejë prapa (refouler) një refugjat në asnjë lloj mënyre në kufijtë e territoreve ku i kërcënohet jeta ose liria për shkak të racës, besimit fetar, kombësisë, anëtarësisë në një grup shoqëror ose opinionit politik”*.

## **2. Shkelja e Konventes Evropiane per te Drejtat e Njeriut.**

Neni 3 i saj ndalon torturën, trajtimin/dënimin çnjerëzor apo poshtërues, teksa përcakton që askush nuk mund të kthehet në një vend që mund ta vendosë atë në rrezik real për të pësuar një nga këto trajtime, duke rënë kështu në kundërshtim me KEDNj. **Ky është për KEDNj parimi i moskthimit.** Sipas KEDNj, ndalimi i përcaktuar nga Neni 3 është në terma absolute, çka do të thotë që është në përgjegjësinë e të gjithë shteteve anëtare të Këshillit të Europës të ruajnë një shtetas të huaj nga një trajtim i tillë dhe rrezikut të kthimit mbrapsht. Aktualisht kjo dispozitë e të drejtës ndërkombëtare është bërë e detyrueshme për të gjitha shtetet (UNHCR,2014:293). Ky parim i ndalon shtetet për të transferuar persona të caktuar në një vend ku ai ose ajo do përballet me një rrezik të vërtetë persekutimi, ose shkelje serioze të të drejtave të njeriut. Parimi i moskthimit është sanksionuar në nenin 33 të Konventës së Refugjatëve të vitit 195 dhe mund të aplikohet për të gjithë individët që janë refugjatë sipas nenit 1 të Konventës së Refugjatëve.

**Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut theksoi se ekstradimi i personit në kundërshtim me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të vitit 1950 do të ketë baza themelore për të besuar se ai do të përballet me rrezikun e të qenit subjekt i torturës, dhe trajtimit mizor çnjerëzor e degradues, ose ndëshkimit në shtetin pranues.**

Ne rastin konkret nga ana e Ministrise se Drejtesise Shqiptare, pas paraqitjes se kerkeses se Prokurorise se Pergjithshme per dhenien rruge te kerkeses per ndihme juridike te shtetit Francez, duhet te ishin hetuar kushtet e kesaj kerkese per ndihme juridike, duhej te verifikoj shtetesia e shtetasit, statusi i qendrimit te tij ne vendin e kerkimit sipas Konventave Evropiane, Direktivave te Keshillit te Evropes dhe ligjeve per Ndhime te Ndersjellte Juridike ne Fushen Penale.

**3. Shkelja e LIGJIT Nr.10193, datë 3.12.2009 PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE,** përcaktohet procedura e dhenies rruge te leterkerkeses se huaj gje qe behet vetem pasi jane vleftesuar kushtet e percaktuara ne legjislacion.

**Neni 7 Përcjellja e letërkërkesës tek autoriteti kompetent**

*1. Ministria e Drejtësisë i jep rrugë letërkërkesës së huaj pasi vlerëson kushtet e përcaktuara në legjislacionin e brendshëm. Në vijim, letërkërkesa i përcillet prokurorit të rrethit ku duhet ekzekutuar letërkërkesa, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm.*

**Neni 8 Refuzimi i letër kërkesës**

1. *Ministria e Drejtësisë dhe autoriteti gjyqësor vendas i japin rrugë letërkërkesës kur plotësohen kushtet e përcaktuara në legjislacionin e brendshëm.*

2. *Këto autoritete mund të refuzojnë letërkërkesat e parashikuara në nenin 4 pika 2 të këtij ligji, edhe për shkaqe të tjera të parashikuara në ligj.*

3. *Në rast të veprave penale kundër njerëzimit apo vlerave të tjera të mbrojtura nga e drejta ndërkombëtare, tentativave për t'i kryer ato, si dhe bashkëpunimit në kryerjen e tyre, Ministria e Drejtësisë dhe autoriteti gjyqësor vendas nuk mund të refuzojnë letërkërkesën me shkakun se përbëjnë vepra penale politike.*

4. *Vendimi i refuzimit të një letërkërkese përmban arsyet e refuzimit dhe bazën ligjore.*

**Ne shkresen ne.347 prot dt.02.12.2015 te Ministrise se Drejtesise Shqiptare** qe i eshte dhene rruge kerkeses per ndihme juridike ne fushen penale te autoriteteve Franceze, ne asnje rrjesht te saj nuk eshte verifikuar as shtetesia e personit, as status i tij i qendrimit ne shtetin Francez, as i eshte kerkuar informacion shtese vendit dergues per te percaktuar sakte kete status, as vleresimi i Legjislacionit te brendshem, as percaktimi i mareveshjes dypaleve te lidhur midis shtetit Francez dhe shtetit Shqiptar per transferimin e procedimit penal duke e bere ne kete menyre nje shkrese formale pa u vleresuar asnje kusht.

**4. Shkelja e DIREKTIVES SE KËSHILLIT TE EVROPES 2003/109/KE, DATË 25 NËNTOR 2003, "PËR STATUSIN E SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA QË JANË REZIDENTË AFATGJATË"**

*Rezidentët afatgjatë duhet të gëzojnë mbrojtje të përforcuar kundër dëbimit. Mbrojtja bazohet në kriteret e përcaktuara nga vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Për të garantuar mbrojtjen nga dëbimi, shtetet anëtare duhet të parashikojnë mbrojtje ligjore efikase.*

f) *"refugjat" është çdo shtetas i vendit të tretë, i cili gëzon statusin e refugjatit brenda kuptimit të Konventës së Gjenevës për statusin e refugjatëve të 28 korrikut 1951, të ndryshuar nga Protokollin i nënshkruar në Nju-Jork më 31 janar 1967;*

**Ne keto kushte, ndjekja penale kunder te pandehurit Domart Konjari nuk duhet te kishte filluar, dhe i kerkojme gjykates te vendos pushimin e gjykimit sipas nenit 387 te K.Pr.Penale.**

Neni 387

**Vendimi i pushimit të çështjes**

*(Ndryshuar pika 1 dhe shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, date 30.3.2017)*

1. Kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë, sipas rasteve të parashikuara në shkronjat “c”, “ç”, “e” dhe “ë”, të paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi, ose kur vepra penale është shuar dhe i pandehuri nuk pretendon pafajësi, gjykata vendos pushimin e çështjes, duke treguar edhe shkakun.

Neni 328

### **Pushimi i akuzës ose çështjes**

(Shtuar pika 1 me ligjin 8460, datë 11.2.1999; ndryshuar titulli dhe pika 1 e shtuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur:

a) del qartë se fakti nuk ekziston;

b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;

c) viktima nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij;

ç) **personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet;**

Neni 329/a

### **Kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes**

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, I nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes.

- II -

Nga ana e autoriteteve Shqiptare gjate ekzekutimit te leterporosive, Eshte shkelur neni 14 i ligjit nr.10193 dt.03.12.2009 PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE si dhe neni 506 dhe 507 i K.Pr.Penale, pasi per ekzekutimin e leterporosise per ndihme juridike te komunikuar nga autoriteti Francez, **nuk eshte paraqitur kerkesa ne gjykate dhe marjen e miratimit me ane te vendimit te Gjykates per ekzekutimin e leterporosise.**

**Veprimet procedurale te kryera nga autoritetet:**

1. Me shkresen nr.11/283/0037 dt.13 nentor 2015 Gjykata e Shkalles se larte te Rennes ka bere kallzim zyrtar prane autoriteteve gjyqesore shqiptare. (*kuptohet kerkese per ndihme juridike me objekt ushtrimin e ndjekjes penale ne shqiperi*)
2. Me shkresen nr.212/9 prot dt.19.11.2015 te Prokurorise se Pergjithshme me lende mbi shtetasin Domart Konjari drejtuar Ministrise se Drejtesise ku nder te tjera shkruhet se, *Autoritetet Franceze te drejtesise kane paraqitur drejtperdrejte nje kerkese per ndihme juridike me objekt ushtrimin e ndjekjes penal ne Shqiperi, ne ngarkim te shtetasit Domart Konjari, duke pasur parasysh pamundesine e ekstradimit nga Shqiperia ne France te ketij subjekti per shkak te shtetesise shqiptare te tij dhe duke qene se ai ndodhet me mase sigurimit "Arrest me burg" ne Shqiperi.*  
*Lidhur sa me siper, mbeshtetur ne Konventen e Keshillit te Evropes per Ndihmen e Ndersjellte Juridike ne fushen penale dhe dy protokollet e saj shtese, nenin 505 te K.Pr.Penale, nenet 5,6,7 te ligjit nr.10193 dt.03.12.2009 "Per maredheniet juridiksionale me autoritetet e huaja ne ceshtjen penale", lutemi ne dhenien rruge nga ana juaj e kesaj leterpororie.*
3. Me shkresen nr.347 prot dt.02.12.2015 te Ministrise se Drejtesise me lende kerkese per ndihme juridike drejtuar Prokurorise se Pergjithshme, *eshte njoftuar dhenia rruge kerkeses per ndihme juridike nr.11/283/0037 dt.13.11.2015 te Prokurorise se Republikes se Rennes France me objekt ushtrimin e ndjekjes penale ne Shqiperi te shtetasit Domart Konjari.*
4. **Me vendimin nr. 341 dt.07.12.2015** te Prokurorise prane ish-Gjykates se Shkalles se Pare per Krimet te Renda Tirane eshte mare Vendimi per regjistrimin e procedimit penal, ne baze te akteve te ardhura nga Drejtoria e Maredheniesve Juridiksionale me Jashte ne Prokurorine e Pergjithshme me shkresen nr.2323 dt.04.12.2015.

**Nga ana e Prokurorise prane ish-Gjykates se Krimeve te Renda te cilit i jane transferuar aktet per ekzekutim sipas shkreses nr.212/12 prot dt.04.12.2015 te Prokurorise se Pergjithshme, nuk eshte paraqitur kerkese ne gjykate per te disponuar per ekzekutimin e leterporosise, por eshte kaluar direkt ne rregjistrim te procedimit penal ne ngarkim te shtetasit Domart Konjari sipas rekomandimit ne shkresen e cituar.**

Neni 10/1 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) parashikon se *"Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare të pranuar nga Shqipëria, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare dhe dispozitat e këtij Kodi"*.



Në bazë të neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara janë pjesë e sistemit juridik shqiptar dhe ato kanë epërsi mbi ligjet e brendshme në kundërshtim me to.

**Dispozitat procedurale te detyrueshme per tu zbatuar:**

- 1. Ne L I G J Nr.8498, datë 10.6.1999 FZ. 21-1999 PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS “PËR NDIHMËN E NDËRSJELLË JURIDIKE NË FUSHËN PENALE” DHE PROTOKOLLIN E SAJ SHITESË** është percaktuar se:

**LETËRPOROSITË**

Neni 3

*1. Pala, së cilës i drejtohet kërkesa, do të ekzekutojë, sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni i vendit të saj, letërporositë që lidhen me një procedim penal që do t'i drejtohen asaj nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese dhe që kanë për objekt përmbushjen e akteve hetimore ose të kalimit të provave materiale që lidhen me veprën penale përkatëse, të fashikujve ose të dokumenteve.*

- 2. LIGJ Nr.10193, datë 3.12.2009 PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE** është percaktuar se:

KREU II

LETËRPOROSITË

Neni 13 **Llojet e letërporosive dhe fusha e zbatimit**

1. Llojet e letërporosive janë:

*a) njoftimi i aktit të thirrjes ndaj personit nën hetim, të pandehurit, dëshmitarit, ekspertit, të dënuarit apo palëve të tjera në procedimin penal;*

*b) njoftimi i urdhrave, i vendimeve të autoriteteve gjyqësore dhe i dokumenteve të tjera të nevojshme që lidhen me procedimin penal në shtetin kërkuës;*

*c) masat e sigurimit pasuror për efekte të një procedimi penal;*

*ç) pyetja e personit nën hetim, të pandehurit, të dënuarit, dëshmitarit dhe ekspertit, qoftë edhe nëpërmjet zhvillimit të seancave dëgjimore me anë të lidhjeve telefonike dhe audiovizive;*

*d) transferimi i përkohshëm i personave të ndaluar, me qëllim pyetjen e tyre;*

*dh) veprime të tjera hetimore, të cilat nuk janë të ndaluara nga ligji.*

**Neni 14 Veprimet për ekzekutimin e letërporosive**

1. *Ministria e Drejtësisë, pas dhënies rrugë, ia përcjell aktet prokurorit të rrethit ku duhet të ekzekutohet letërporosia, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, brenda 10 ditëve nga marrja e akteve. Në raste urgjente, Ministria e Drejtësisë mund t'ia përcjellë aktet prokurorit të rrethit, duke njoftuar njëkohësisht Prokurorin e Përgjithshëm.*

2. Prokurori i Rrethit paraqet kërkesën në gjykatë për të disponuar ekzekutimin e letërporosisë me vendim, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale. Ky rregull nuk zbatohet kur parashikohet ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

### **3.Kodi i Procedures Penale percakton se:**

#### **Neni 506**

##### **Procedimi gjyqësor**

*(Shtuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 99, datë 31.7.2014)*

1. Letërporosia e huaj nuk mund të vihet në ekzekutim pa u marrë më parë vendimi në favor i gjykatës së vendit ku duhet të procedohet.

2. Prokurori i rrethit, pasi merr aktet nga Ministria e Drejtësisë, paraqet kërkesën në gjykatë brenda 5 ditëve nga paraqitja e akteve nga Ministria e Drejtësisë.

3. Gjykata disponon ekzekutimin e letërporosisë me vendim brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

4. *Ekzekutimi i letërporosisë nuk pranohet:*

a) *kur janë rastet që Ministria e Drejtësisë nuk i jep rrugë letërporosisë, në përputhje edhe me parashikimet e akteve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe rezervat e deklarimet ligjore;*

b) *kur fakti për të cilin procedon autoriteti i huaj nuk parashikohet nga ligji shqiptar si vepër penale.*

#### **Neni 507**

##### **Ekzekutimi i letërporosive**

*(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

1. *Gjykata që pranon kërkesën për ekzekutimin e letërporosisë, kryen dhe veprimin e kërkuar ose autorizon për këtë qëllim prokurorin, në rastet kur ligji e lejon.*

2. Për kryerjen e veprimeve të kërkuara zbatohen normat e këtij Kodi, përveç rasteve kur duhet të respektohen rregulla të veçanta të kërkuara nga autoriteti gjyqësor i huaj, të cilat nuk vijnë në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit Shqiptar.

**Ne kete kontekst, si rregjistrimi i procedimit penal nr.341 dt.07.12.2015 bere nga Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krimeve te Renda Tirane, ashtu edhe marja e akteve ne kuader te kesaj kerkeses per ndihme juridike me objekt ushtrimin e ndjekjes penale ne Shqiperi te bere nga Autoritete e Drejtesise Franceze jane bere ne kundeshitim me nenin 506-507 te K.Pr.Penale dhe ne kundeshitim me nenin 14 te ligjit Nr.10193, datë 3.12.2009 PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE, gje qe i ben keto veprime absolutisht te pavlefshme dhe nul.**

- III -

Nga ana e organit te akuzes dhe gjykates se posacme nuk eshte percaktuar sakte dhe qarte natyra e kerkeses se shtetit te huaj sic eshte shteti Frances, gje qe ka sjelle edhe vleresim te gabuar te situates juridike.

Pavaresisht se nga ana e organit te Prokurorise kjo ceshtje eshte paraqitur sikur rregjistrimi i procedimit penal eshte bere ne baze te nenit 6 te K.Pr.Penale, realisht ne gjendjen sesi jane paraqitur shkresat nga autoriteti i huaj kemi te bejme me nje **trasferim te procedimit penal dhe jo ekzekutimin e nje leterporosie te huaj.**

Me shkresen nr.11/283/0037 dt.13 nentor 2015 Gjykata e Shkalles se Larte te Rennes ka bere denoncim zyrtar prane autoriteteve gjyqesore shqiptare per **te ushtruar perndjekjen penale kunder Domart Konjarit.**

1. Bazuar ne L I G J Nr.8497, date 10.6.1999 FZ. 21-1999 PER RATIFIKIMIN E KONVENTES SE KESHILLIT TE EUROPES "PER TRANSFERIMIN E PROCEDIMEVE NE ÇËSHTJET PENALE" eshte percaktuar se:

Neni 3

*Cdo shtet kontraktues, duke pasur sipas ligjit te tij kompetencen per te ndjekur penalisht nje veper penale, per qellimet e zbatimit te kesaj Konvente, mund te heqe dore ose te nderprese procedimet kunder personit te dyshuar, i cili eshte duke u ndjekur penalisht ose do te ndiqet per te njejten veper penale, nga nje shtet tjetër kontraktues.*

**Transferimi i procedimeve**

## SEKSIONI I

### Kerkesa per Procedime

#### Neni 6

1. Kur nje person eshte dyshuar per kryerjen e nje vepre penale sipas ligjit te nje shteti kontraktues, ky shtet mund t'i kerkoje nje shteti tjeter kontraktues qe te filloje procedimet ne rastet dhe sipas kushteve te parashikuara ne kete Konvente.
2. Ne qofte se sipas dispozitave te kesaj Konvente nje shtet kontraktues mund t'i kerkoje nje shteti tjeter kontraktues qe te filloje procedimet, atehere autoritetet kompetente te shtetit te pare do ta vleresojne kete mundesi.

## SEKSIONI III

### Pasojat e nje kerkese per procedim gjyqesor ne shtetin kerkues

#### Neni 21

- 1 . Kur shteti kerkues ka kerkuar procedime, ai nuk mund te ndjeke me penalisht personin e dyshuar per kryerjen e vepres penale per te cilen jane kerkuar keto procedime ose te kerkoje zbatimin e nje vendimi gjyqesor, i cili ka qene shpallur me pare ne ate shtet ndaj tij per ate shkelje. Megjithate, derisa te merret vendimi i shtetit te kerkuar ne lidhje me kerkesen per procedime, shteti kerkues, do te kete te drejten per te ndermarre te gjithë hapat ne lidhje me ndjekjen penale, pa e cuar ceshtjen ne gjyq ose sipas rastit, duke lejuar autoritetin administrativ te vendose per ceshtjen.

**Ne rastin konkret, duke u nisur nga natyra e kerkeses se bere nga autoriteti i huaj Frances, te ciles i jane bashkelidhur kopje e kerkeses per gjykim te Prokurorit Frances, kopje te akteve te procedimit penal dhe vendimin penal te gjykates Franceze, gjykojme se kemi te bejme me nje kerkese per procedim ndaj nje shtetasi sipas tyre me shtetesi shqiptare dhe jo thjesht me nje kerkese per ndihme juridike ne ceshtjet penale.**

Kjo gjë duhet te ishte vleresuar nga ana e autoriteteve gjyqesore shqiptare duke percaktuar qarte natyren e kerkeses dhe vleresimin e situates.

2. Ne respektim te Konventes se Keshillit te Europes per “*Tranferimin e Procedimeve Penale*”, seksioni III neni 21, kur kemi nje kerkese per procedim gjyqesor ne shtetin kerkues, shteti kerkues nuk mund ta ndjeke më penalisht personin e dyshuar ose te kerkoje zbatimin e nje vendimi.

Ne keto kushte nga autoriteti kerkues Frances duhet te merej vendimi per pushimin e gjykimit penal ne ngarkim te te pandehurit Domart Konjari duke ia kaluar te drejten e fillimit te procedimit shtetit te kerkuar sic eshte Shqiperia.

**Ne rastin konkret kemi nje shkelje te Konventes, pasi te dy shtetet kane procedimet penale te hapura kunder te njejtit shtetas per te njejtat vepra penale, nga njera ane shteti Frances eshte ne pritje te dates se gjykimit nga gjykata e apelit dhe nga ana tjeter shteti shqiptar eshte ne gjykim te procedimit nga Gjykata e Posacme kunder Korrupsionit dhe Krimin te Organizuar.**

**Kjo situatë është absurde pasi ne perfundim do te kemi 2 vendime penale kunder te njejtin person per te njejtin fakt, per te njejtat vepra penale, mbi te njejtat prova, por te gjykuara nga dy gjykata te dy shteteve te ndryshme, gje qe do te sillte shkelje te parimit “Ne Bis in Dem”.**

Gjithashtu jemi te bindur se **nuk jemi perpara kushteve te zbatimit te Konventes Europiane per ndihme te ndersjellte ne ceshtjet penale** sic shprehet autoriteti gjyqesor Frances, pasi kjo konvente e ka percaktuar objektin e veprimeve penale sic jane:

## LETËRPOROSITË

### Neni 3

1. *Pala, së cilës i drejtohet kërkesa, do të ekzekutojë, sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni i vendit të saj, letërporositë që lidhen me një procedim penal që do t'i drejtohen asaj nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese dhe që kanë për objekt përmbushjen e akteve hetimore ose të kalimit të provave materiale që lidhen me veprën penale përkatëse, të fashikujve ose të dokumenteve.*

Me kete nenkuptohet, se kjo konvente gjen zbatim ne ekzekutimin e leterporosive te nje shteti te huaj qe kane te bejne per kryerjen e veprimeve hetimore me qellim qe te ndihmoje shtetin kerkues te perfundoje procedimin e tij penal, dhe jo sic eshte kerkuar ne rastin konkret per te transferuar gjithë procedimin penal duke kerkuar fillimin e ndjekjes penale me aktet e procedimit penal te kryer nga shteti kerkues.

Gjithashtu, **shteti shqiptar ka bere nje rezerve ne lidhje me miratimin e kesaj Konvente duke, refuzuar dhenien e ndihmes juridike ne fushen penale te cilat jane ne hetim ne territorin e Shqiperise ose ne nje vend tjeter, cka duhet kuptuar qe kur per te njejtin person eshte i hapur nje proces hetimi ne nje vend tjeter, autoritetet shqiptare do te refuzojne dhenien**

ndihme juridike, qe konsiston si ne zbatimin e leterporosive ashtu edhe ne fillimin e ndjekjes penale.

**DEKLARIME DHE REZERVIME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË  
“KONVENTËN EUROPIANE TË NDIHMËS JURIDIKE NË FUSHËN PENALE”  
REZERVIME**

**Neni 2**

*Republika e Shqipërisë do të refuzojë dhënien e ndihmës juridike në fushën penale:*

- a) për vepra penale të cilat nuk parashikohen si të tilla nga legjislacioni penal shqiptar në fuqi;*
- b) për ato vepra penale të cilat janë në proces hetimi në territorin e Republikës së Shqipërisë ose në një shtet tjetër.*

**3. Ne ligjin Nr.10193, datë 3.12.2009 PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE  
ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE është percaktuar se:**

**TRANSFERIMI I PROCEDIMEVE PENALE NGA SHTETET E HUAJA**

**Neni 71**

Kushtet për pranimin e procedimit penal nga një shtet i huaj

1. Ministri i Drejtësisë mund të pranojë transferimin e procedimit penal në Shqipëri kur:

- a) personi i dyshuar ka vendbanimin ose vendqëndrimin në Shqipëri; dhe*
- b) nuk është i mundur ose i përshtatshëm procedimi i personit në shtetin kërkues për një ose më shumë nga shkaqet e mëposhtme:*
  - i) personi i dyshuar është shtetas shqiptar ose shteti shqiptar është shteti i tij i origjinës;*
  - ii) personi i dyshuar është duke vuajtur ose duhet të vuajë një dënim me burgim në Shqipëri;*
  - iii) autoritetet gjyqësore vendase kanë filluar procedimin penal për të njëjtën vepër penale ose për vepra të tjera penale kundër personit të dyshuar;*
  - iv) çmohet se transferimi i procedimit penal i shërben zgjidhjes së drejtë e të përshtatshme të çështjes dhe procesit të rregullt ligjor;*
  - v) ekzekutimi i dënimit penal të dhënë në Shqipëri mund t'i shërbejë një rehabilitimi më të mirë social të personit të dënuar;*
  - vi) nuk mund të sigurohet thirrja dhe pjesëmarrja e personit të dyshuar në procedimin penal në shtetin kërkues;*

vii) ekzekutimi i një dënimi të mundshëm me burgim në shtetin kërkues mund të jetë i vështirë dhe nuk mund të realizohet nëpërmjet procedurës së ekstradimit apo është refuzuar kërkesa për ekstradim.

2. Transferimi i procedimit penal nuk pranohet nëse ekziston ndonjë prej rrethanave që nuk lejon fillimin e procedimit penal të parashikuar nga legjislacioni i brendshëm.

#### 4. Kodi i Procedures Penale .

Neni 10/1 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) parashikon se “Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare të pranuar nga Shqipëria, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare dhe dispozitat e këtij Kodi”.

5. **Në bazë të neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës**, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara janë pjesë e sistemit juridik shqiptar dhe ato kanë epërsi mbi ligjet e brendshme në kundërshtim me to. Gjithashtu, këto dispozita ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejtë, me përjashtim të rastit kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe për zbatimin e tyre kërkohet nxjerrja e një ligji.

#### 6. Eshte shkelur parimi i “bazueshmerise ne ligj” i provave te mara nepermjet leterporosive nderkombetare.

Leterporosite nderkombetare, perbejne mjete per marjen e provave per efekt te nje procesi penal ne nje shtet te huaj dhe me kerkese te autoritetit te huaj perkates.

Qe keto prova te jene te vlefshme dhe te perdorshme nga kerkuesi i leterporosise, eshte e rendesishme qe marja e tyre nga ekzekutuesi i leterporosise te behet ne perputhje me procedurat ligjore te percaktuara per marjen e proves perkatese.

**Vendim i Gjykates Kushtetuese nr.23 dt.23.07.2009.**

- IV-

Prokuroria prane Gjykates per Krimet e Renda Tirane **nuk ka mare vendimin per komunikimin e akuzes te pandehurit Domart Konjari, duke e kaluar ceshtjen direkt ne paraqitjen e kerkeses per gjykim perpara gjykates.**

Mungesa e nje veprimi te tille procedural i ka mohuar te drejten te pandehurit Domart Konjari te njihet me akuzen ne ngarkim te tij dhe te parashtroje te drejten e tij per kerkimin dhe marjen e

provave, duke perbere keshtu nje shkelje te se drejtes themelore te informimit per aktet ne ngarkim te tij.

1. Ne LIGJ Nr.10 193, datë 3.12.2009 PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE percaktohet se:

**Neni 73 Veprimet e prokurorit**

*1. Prokurori i Rrethit Gjyqësor ose ai i Krimeve të Rënda, me marrjen e kërkesës dhe akteve për transferim, regjistron procedimin penal dhe ndjek rregullat e Kodit të Procedurës Penale.*

*3. Prokurori që procedon, njofton Ministrinë e Drejtësisë nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm për çdo vendim që pezullon ose përfundon procedimin penal.*

*Ministri i Drejtësisë ia përcjell menjëherë këto akte shtetit kërkuës.*

2. **Në nenin 6/3 (a) të Konventes Europiane per te Drejtat e Njeriut** sanksionohet se: *“Çdo i akuzuar, ka të drejtë pikërisht që: a-të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton, dhe në mënyrë të hollësishme për natyrën dhe shkakun e akuzës që bëhet kundër tij”.*

3. **Në vendimet e saj, Gjykata Europiane** ka vënë në dukje se: *“koncepti i akuzës duhet trajtuar brenda kuptimit që i jep Konventa, sipas së cilës akuza mund të përkufizohet si njoftimi zyrtar dhënë një individ nga autoriteti kompetent, për pretendimin se ai ka kryer një vepër penale dhe që ndryshon në mënyrë substanciale pozitën e tij. Që nga ky moment, personit të akuzuar i lind e drejta për të kërkuar “një proces të rregullt ligjor”. Kjo nënkupton, detyrimin e organit procedues për respektimin e kërkesave të nenit 6 të Konventës, sepse që nga ky moment fillon të llogaritet “afati i shkurtër” i njoftimit të akuzës. Gjykata Europiane ka theksuar se, ky njoftim duhet bërë me shkrim si dhe të përmbajë bazën faktike dhe ligjore të kësaj akuze, e shprehur kjo në gjuhën që kupton i pandehuri, sepse në të kundërt ai do të vihej në disavantazh dhe nuk do të mund të përgatiste mbrojtjen ndaj kësaj akuze”.*

4. **Nëse i referohemi nenit 31/a të Kushtetutës**, kemi pothuajse të njëjtin formulim: *“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: a-të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t’i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij”.*



Nëpërmjet kësaj dispozite, Kushtetuta i zgjeron më tej garancitë e të pandehurit, duke parashikuar si detyrim për organin procedues e dhe njohjen e të pandehurit me të drejtat e tij në këtë fazë të procedimit, që nga momenti i njoftimit të akuzës.

5. Në përputhje me këtë dispozitë kushtetuese, ky detyrim parashikohet për organin procedues në **nenin 39 të K. Pr. Penale**, sipas të cilit: *“organi procedues i shpjegon të pandehurit faktin që i atribuohet, e njeh me provat në ngarkim të tij ...”*.

Kjo e drejtë e të pandehurit, përbën një detyrim kushtetues për organin procedues, sepse vetëm duke ditur akuzën në ngarkim të tij, i pandehuri mund të sqarojë pozitën e tij rreth fajësisë apo pafajësisë, si dhe të mund të mbrohet ndaj saj.

Gjithashtu, siç përmendëm më lart, organi procedues është i detyruar në bazë të Kushtetutës, ta vërë në dijeni të pandehurin dhe t'i shpjegojë të drejtat që ai gëzon në këtë fazë të procedimit. Në nenin 34 të K. Pr. Penale, parashikohet që akti i akuzës i njoftohet të pandehurit. Ky veprim duhet të behet në prani të mbrojtësit (nëse kërkohet), detyrim i cili rrjedh nga e njëjta dispozitë. Në të kundërt, njoftimi i aktit të akuzës, në reference të nenit 128/c të K. Pr. P., është absolutisht i pavlefshëm.

#### **Neni 34 K.Pr.P Marrja e cilësisë së të pandehurit,**

##### **Neni 34/a Të drejtat e të pandehurit**

*1. Personi nën hetim ose i pandehuri ka të drejtë:*

*a) të njoftohet në një kohë sa më të shkurtër, në gjuhën që kupton,*

*për veprën penale për të cilën hetohet, si edhe për shkaqet e akuzave;*

*b) të përdorë gjuhën që flet ose kupton ose të përdorë gjuhën e shenjave, si dhe të ndihmohet nga një përkthyes dhe interpretues nëse ka paaftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;*

*c) të heshtë, të paraqesë lirisht mbrojtjen e tij, si dhe të mos u përgjigjet pyetjeve të caktuara;*

*ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij;*

*d) të ketë një mbrojtës të siguruar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose nuk ka mundësi financiare për të pasur një mbrojtës, sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi për ndihmë juridike;*

*dh) të takohet privatisht dhe të komunikojë me mbrojtësin që e përfaqëson;*

*e) të këtë kohë të mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen;*

*ë) të njihet me materialet e çështjes, sipas parashikimeve të këtij Kodi;*

*f) të paraqesë prova që i shërbejnë mbrojtjes së tij;*

g) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve, ekspertëve dhe të pandehurve të tjerë gjatë gjykimit;

gj) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.

2. Përpara marrjes në pyetje për herë të parë ose përpara kryerjes së akteve ku prania e tij është e detyrueshme, sipas ligjit, organi

Sic shihet edhe nga shenimi i bere ne kallzimin e autoritetit Frances per ndihme juridike, gjykimi **ne gjykatën Franceze kunder te pandehurit Domart Konjari eshte zhvilluar ne mungese**, pra ai nuk ka asnje informacion mbi kete gjykim. Ne te njejten menyre ka vepruar edhe ish-Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krimet e Renda, pasi ka bere rregjistrimin e procedimit penal ne ngarkim te Domart Konjarit, nuk i ka komunikuar atij asnjehere akuzen konkrete te ketij organi procedures dhe as provat e grumbulluara ne ngarkim te tij si dhe as kerkimet e tjera qe ky organ procedures ka ndjekur per hetimin e kesaj ceshtjeje.

**6.Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 21, datë 24.07.2006**,shprehet se “Gjykata Kushtetuese çmon se në rrethanat kur kërkuesi është gjykuar e dënuar në mungesë, pa u vënë në dijeni personalisht në lidhje me akuzat dhe procesin në ngarkim të tij, i duhet garantuar e drejta për të pasur një gjykim në përputhje me nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut”. Sa më lart, komunikimi i akuzës së të pandehurit konfirmohet edhe një herë si pjesë e procesit të rregullt ligjor, në kuadër të nenit 6 te Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Mungesa e komunikimit të akuzës, shkakton pavlefshmëri absolute te ndjekjes penale dhe gjykimit, e për pasojë, edhe prishjen e tyre. Lidhur me komunikimin e akuzës, si pjesë e të drejtave të garantuara në nenin 6 të KEDrNJ, është shprehur edhe Gjykata e Strasburgut në çështjen “Berhani kundër Shqipërisë”, e cila ka përcaktuar sa vijon: “Aplikanti u ankua në bazë të Nenit 6/3 (a), (b) dhe (c) se: nuk ishte informuar për akuzat nga prokuroria; nuk kishte pasur kohë të mjaftueshme për t’u vetëmbrojtur; dhe nuk kishte pasur mundësi të caktonte avokat mbrojtës sipas zgjedhjes së tij sepse nuk ishte informuar për procedimin penal” . Në rastin Berhani, Gjykata e Strasburgut ka konstatuar shkelje të të drejtave të mësipërme e për pasojë ka penalizuar shtetin shqiptar.

- V -

**Ne kete procedim jane shkelur dispozitat proceduriale te Kodit te Procedures Penale Shqiptar ne lidhje me pyetjen e bashke te pandehurve dhe deshmitareve** sipas leterporosise gjyqesore te Gjykates se Shkalles se pare per Krimet e Renda me shkresen nr.905 prot dt.18.06.2018 ku eshte kerkuar pyetja per personat me **cilesine e personave ndaj te cileve ka**

**nisur dhe eshte perfunduar procedimi penal** ne France si me poshte.1. Jacques La Rosa,2. Soufiane Amsaaf, 3.Fatmir Hajdini,4.Defrim Zepaj,5.Marc Rivelli, 6.Davy Franga, 7.Janathan Belotti, 8.Ramazan Sina, 9.Abdel Bajraktarovix, 10.Ilir Gashi, 11.Ilir Vataj, 12.Entony Bega. Njekoheshish kerkohet pyetja me **cilesine e deshmitareve**.1.Ermira Cuka, 2.Stephanie Eon, 3.Souriac Jennifer, 4.Julien Xhela, 5.Astrid Pondosa, 6.Laetitia Kiswaoui. Personat e pare te cilet jane me cilesine e **personave ndaj te cileve ka nisur dhe eshte perfunduar procedimi penal** , per pyetjen e tyre duhet te zbatoheshin dispozitat procedurale te parashikuara ne K.Pr.Penale.

### **Neni 193**

#### **Marrja e procesverbaleve të procedimeve të tjera**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

1. *Lejohet marrja e procesverbaleve të marrjes së provës të procedimeve të tjera penale që kanë të bëjnë me sigurimin e proves ose me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.*
2. *Lejohet marrja e procesverbalit të provës në një gjykim civil të përfunduar me vendim të formës së prerë.*
3. *Në rastet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2, procesverbalet e deklarimeve mund të përdoren kundër të pandehurit vetëm nëse mbrojtësi i tij ka qenë i pranishëm në marrjen e tyre.*
4. *Lejohet marrja e akteve të veprimeve që nuk mund të përsëriten, përfshirë edhe deklaratimet e të pandehurit, kur provohet pamundësia objektive e marrjes, e pa parashikueshme në kohën e kryerjes së veprimit.*
5. *Përveç rasteve të parashikuara në paragrafët e mësipërm, procesverbalet e provës mund të përdoren në shqyrtimin gjyqësor vetëm kur i pandehuri jep pëlqimin. Në rast të kundërt, ato mund të përdoren për bërjen e kundërshtimeve të parashikuara nga nenet 362 dhe 365 të këtij Kodi.*
6. *Palët kanë të drejtë të kërkojnë pyetjen e personave, deklaratimet e të cilëve janë marrë sipas parashikimeve të këtij neni.*

#### **Pyetja e një personi të marrë si i pandehur në një procedim të lidhur**

*(Shtuar pika 4/1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

3. *Personat e treguar në paragrafin 1 ndihmohen nga mbrojtësi i zgjedhur dhe në mungesë të tij nga një mbrojtës i caktuar kryesisht.*
4. *Para se të fillojë pyetja, gjykata i njofton personat e treguar në paragrafin 1 se kanë të drejtë të mos përgjigjen.*

Per garantimin e kesaj dispozite duhet te ishin mare masa nga autoriteti kerkues i leterporosise sic eshte Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare, i cili se bashku me kerkesen duhet ti paraqiste organit prites edhe garantimin e respektimit te procedurave proceduriale te cilat jane te permenduar ne ligjin vendas.

Duke gene se kjo prove eshte kerkuar te meret nga ish-Gjykata e Shkalles se Pare per Krimet te Renda Tirane, per pyetjen e tyre do te ndiqen dhe zbatohen te gjitha dispozitat ligjore sikur keta shtetas te pyeteshin perpara ketij autoriteti, pasi kjo prove do ti nenshtrohet rregullava te K.Pr.Penale Shqiptare dhe pas marjes se saj, do i nenshtrohen debatit gjyqesor dhe berja e tyre pjese e fashikullit te gjykimit.

Konkretisht, keta shtetas jane pyetur dhe eshte derguar procesverbali i pyetjeve me shkresen e dt.26.09.2018 te Ministrise se Brendshme Franceze sipas kronologjise.

1. Per shtetasin Luigji Vataj lindur ne 03.02.1958 ne Shkoder Shqiperi, i liruar dt.05.10.2016, **i larguar per ne shtetin Shqiptar dt.05.10.2016.**
2. Per shtetasin dt 05.11.2018 Jacques la Rosa eshte ne shtetin Italian duke vuajtur denimin dhe se **eshte e pamundur qe te procedohej me degjesen e personit** te interesuar ne kuader te hetimit.
3. Per shtetasin Belotti Jonathan, lindur me 29.11.1981 ne marseje me kombesi Franceze. Per kete shtetas *duhet te ishin percaktuar rregullat e pyetjes nga autoriteti kerkues sic eshte prokuroria Shqiptare, pasi ky shtetas eshte bashke i pandehur ne te njejtin procedim me te pandehurin Domart Konjari, duhet ti behej me dije prapakisht mbi te drejten e tij per te mos deshmuar, te drejten e tij per tu asistuar nga nje mbrojtjes i caktuar prej tij ose kryesisht, te drejta as te treguara dhe as te garantuara nga autoriteti Francez qe kryen pyetjen mbi kerkesen e autoritetit Shqiptar.*
4. Per pyetjen e shtetasit Ortega Astrid e ve Ponsoda,dt.13.03.2019 e dtl.30.03.1939 lindur ne Algjeri me kombesi Franceze, ne baze te leterporosise te autoritetit gjyqesor Shqiptar ky shtetas kerkohet te pyetet me cilesine e deshmitarit. *Per kete shtetas nuk ka asnje formule betimi te lexuar nga autoriteti Francez dhe as eshte betuar si deshmitar per te thene te verteten mbi pyetjet e drejtuar. Prandaj ky procesverbal eshte i pavlefshem dhe nuk mund te perdoret.*
5. Pyetja e shtetasit Laetitia Kusraoui dt.15.03.2019, e dtl.09.12.1975 me kombesi Franceze me cilesine e deshmitares, eshte bere formula e betimit.

6. Pyetja e shtetasit Julien Khela dt.18.03.2019, i dtl.29.06.1978, lindur ne Kosove me kombesi Franceze eshte kerkuar te pyetet me cilesine e deshmitarit, eshte bere formula e betimit.
7. Per pyetjen dt.19.03.2019 e shtetasit Marc Rivelli, dtl 01.07.1954 me kombesi Franceze *me cilesine e bashke te pandehurit, duhet ti behej me dije prapakisht mbi te drejten e tij per te mos deshmuar, te drejten e tij per tu asistuar nga nje mbrojtjes i caktuar prej tij ose kryesisht*, te drejta as te treguara dhe as te garantuara nga autoriteti Francez qe kryen pyetjen mbi kerkesen e autoritetit Shqiptar.
8. Per pyetjen dt.20.03.2019 te shtetases Ermira Cuka, e dtl.27.03.1981 , lindur ne Tirane me kombesi Shqiptare. *Kjo shtetase ka qene ish bashkeshortja e Domart Konjarit,ne kerkimin e pyetjes se kesaj shtetase autoriteti Shqiptar si autoritet kerkues duhet ti bente me dije autoritetit pyetes se per kete shtetase duhet te respektohej neni 158 i K.Pr.Penale Shqiptare ne lidhje me perjashtimin nga detyrimi per te deshmuar i kesaj shtetase.* Nje gje e tille as eshte kerkuar dhe as eshte respektuar nga autoriteti pyetes sic eshte shteti Francez. Prandaj ky procesverbal i pyetjes se ketij shtetsi eshte i pavlefshem dhe si rrjedhoje i pa perdorshme ne kete gjykim.
9. Pyetja dt.26.03.2019 e shtetasit Davy Fraga i dtl.30.12.1976 me kombesi Franceze, edhe ky shtetas *eshte ne te njetin procedim penal si Domart Konjari dhe eshte me cilesine e bashke te pandehurit, duhet ti behej me dije prapakisht mbi te drejten e tij per te mos deshmuar, te drejten e tij per tu asistuar nga nje mbrojtjes i caktuar prej tij ose kryesisht*, te drejta as te treguara dhe as te garantuara nga autoriteti Francez qe kryen pyetjen mbi kerkesen e autoritetit Shqiptar.
10. Pyetja dt.23.07.2019 e shtetasit Ramazan Sina, lindur me 11.01.1961 ne Lushnje Shqiperi me kombesi Shqiptare edhe *ky shtetas eshte ne te njetin procedim penal si Domart Konjari dhe eshte me cilesine e bashke te pandehurit, duhet ti behej me dije prapakisht mbi te drejten e tij per te mos deshmuar, te drejten e tij per tu asistuar nga nje mbrojtjes i caktuar prej tij ose kryesisht*, te drejta as te treguara dhe as te garantuara nga autoriteti Francez qe kryen pyetjen mbi kerkesen e autoritetit Shqiptar.
11. Pyetja dt.12.04.2019 e shtetasit Ilir Gash ii dtl.09.02.1971 ne Tirane Shqiperi, me kombesi Shqiptar, edhe *ky shtetas eshte ne te njetin procedim penal si Domart Konjari dhe eshte me cilesine e bashke te pandehurit. duhet ti behej me dije prapakisht mbi te drejten e tij per te mos deshmuar, te drejten e tij per tu asistuar nga nje mbrojtjes i caktuar prej tij ose*

*kryesisht, te drejta as te treguara dhe as te garantuara nga autoriteti Francez qe kryen pyetjen mbi kerkesen e autoritetit Shqiptar.*

12. Pyetja dt.20.03.2019 e shtetasit Soufiane Amsaaf e dtl.03.12.1983 me shtetesi Franceze, edhe *ky shtetas eshte denuar ne te njetin procedim penal si Domart Konjari dhe eshte me cilesine e bashke te pandehurit. duhet ti behej me dije praprkisht mbi te drejten e tij per te mos deshmuar, te drejten e tij per tu asistuar nga nje mbrojtjes i caktuar prej tij ose kryesisht, te drejta as te treguara dhe as te garantuara nga autoriteti Francez qe kryen pyetjen mbi kerkesen e autoritetit Shqiptar.*

• VI -

**Prova me deshmitare dhe deklarimet e bashke te pandehurve.**

**Nga pyetja e bashke te pandehurve dhe deshmitareve nuk u provua jashte cdo dyshimi te arsyeshem per kryerjen e vepres penale nga i pandehuri Domart Konjari.**

- **Sipas procesverbalit te pyetjes te bashke te pandehurit Safiane Amsaaf dt.20.03.2019, nuk eshte mare asje e dhene implikues per te pandehurin Domart Konjari...**

Pyetjes a e njihni shtetasin Domart Konjari, *ai pergjigjet jo.*

Pyetjes cfare maredhenie keni me shtetasin Domart Konjari, *ai pergjigjet nuk ka pasur kurre maredhenie me te.*

Pyetjes a e dini qe Domart Konjari ka kryer akte te paligjshme...*ai pergjigjet se nuk e njohe dhe nuk di se cka bere.*

Te gjitha pyetjeve te tjera qe i jane bere nga organi procedues, *ai pergjigjet, nuk e di, nuk e mbaj mend, etj.*

- **Pyetja e bashke te pandehurit Beloti Jonathan 13.03.2019**, nuk del asnje e dhene implikuese kunder te pandehurit Domart Konjari.

Pyetjes se ne c'fare rrethana e keni njohur shtetasin Domart Konjari ai pergjigjet, *e kam njohur sepse ai ishte kunati i kusherit tim Ponsoda.*

Pyetjes se a keni dijeni nese shtetasit Domart Konjari ka kryer veprime te paligjshme, *ai pergjigjet jo.*

Pyetjeve te tjera ai pergjigjet *nuk me kujtohet asgje, nuk e di..*

- **Pyetja e deshmitares Ortega Astrid Ponsoda dt.13.03.2019**, per kete deshmitare nuk eshte bere formula e betimit, *pandaj ky procesverbal eshte i pavlefshem.*

Gjithsesi kjo deshmitare eshte pergjigjur pyetjeve *qe nuk e njeh shtetasin Domart Konjari, as ka komunikuar ndodnjehere me te, as ka pasur dijeni se me cfare merej.*

- **Pyetja e deshmitares Laetitia Kisraoui dt.15.03.2019**, nga kjo deshmitare nuk del asnje e dhene implikuese kunder Domart Konjarit.

Kjo deshmitare eshte pergjigjut pyetjeve *qe nuk e njeh shtetasin Domart Konjari, as ka komunikuar ndodnjehere me te, as ka pasur dijeni se me cfare merej.*

- **Pyetja e deshmitarit Julien Khela dt.18.03.2019**, nga ky deshmitare nuk del asnje e dhene implikuese kunder Domart Konjarit.

Gjithsesi ky deshmitare eshte pergjigjut pyetjeve *qe nuk e njeh shtetasin Domart Konjari, as ka komunikuar ndodnjehere me te, as ka pasur dijeni se me cfare merej.*

- **Pyetja e bashketepandheurit Mark Riveli**, nuk del asnje e dhene implikuese per Domart Konjarin.

Pyetjes se cfare maredhenie keni me Domart Konjarit, *ky i pergjigjet, miqesore,*

pyetjes se a keni dijeni qe shtetasi Domart Konjari ka kryer veprime te paligjshme, *ky i pergjigjet, se nuk e di.*

Vazhdimi i pyetjeve , *iu eshte pergjigjur se nuk e di, e nuk me kujtohet.*

- **Pyetja e deshmitares Ermina Cuka dt.20.03.2019.** *Kjo shtetase ka qene ish bashkeshortja e Domart Konjarit ,ne kerkimin e pyetjes se kesaj shtetase autoriteti Shqiptar si autoritet kerkues duhet ti bente me dije autoritet pyetes se per kete shtetase duhet te respektohej neni 158 i K.Pr.Penale Shqiptare ne lidhje me perjashtimin nga detyrimi per te deshmuar i kesaj shtetase.* Nje gje e tille as eshte kerkuar dhe as eshte respektuar nga autoriteti pyetes sic eshte shteti Francez. **Prandaj ky procesverbal i pyetjes se ketij shtetsi eshte i pavlefshem dhe si rrjedhoje i pa perdorshme ne kete gjykim.**

Te gjitha pyetjeve qe i jane bere ne vazhdimesi, *kjo shtetase i eshte refuzuar te pergjigjet.*

- **Pyetja e bashke te pandehurit Davy Fraga dt.26.03.2019.**

Pyetjes se e e njihni Domart Konjarit, *ky pergjigjet se po.*

Pyetjes se ne crrethana jeni njohur me Domart Konjarin , *ky pergjigjet per maredhenie tregtare.*

Pyetjes se a keni dijeni ju nese shtetasi Domart Konjari ka kryer veprimetari te paligjshme, *ky pergjigjet, se sinqerisht nuk e dija qe merej me droge, e shikoja me shume nga aparencat e tij si nje tutor femrash.*

Pyetjes se kush eshte personi qe ju ka furnizuar me kokaine, *i pergjigjet se furnizohesha tek Marc Rivelli.*

Pyetjes se shoku i ngusht “miku” i Marc Rivellir dhe i Konjarit eshte pare ne NIS ..a eshte e mundur qe “miku” i permendur me lart te jete Domart Konjari? Ky pergjigjet se: nuk e di. Tani

qe e njoh mund te them po, por ne kohen e fakteve te ndodhura nuk e dija qe ishte Domarti qe furnizonte Markun me kokaine e kam mesuar kete vetem kur u arrestova.

Nisur nga permbajtja e pyetjeve, del qarte se ato jane sugestionuese pasi jepet emri i personit "Domart Konjari" pastaj behet pyetja, duke e orientuar personit te pergjigjet drejt tij.

**Ky shtetas ka deklaruar hapur se nuk e blinte drogen nga Domart Konjari por nga nje person tjeter, dhe se per Domartin e ka mare vesh kur u arrestua, dmth e ka mare vesh nga Policia dhe ketu fillon gjithë inskenimi i pergjigjeve te panjohura me pare prej tij.**

- **Pyetja e bashke te pandehurit Ramazan Sina dt.23.07.2019, , nuk del asnje e dhene implikuese per Domart Konjarin.**

Pyetjes se a e njihni Domart Konjarin, ai pergjigjet se e njoh si emer si shqiptar por s'kam pasur asnje kontakt me te.

Pyetjes se ne c'rrethana jeni njohur me shtetasin Domart Konjai, ai pergjigjet se heren e pare qe e degjova emriu e tij ishte kur per te me foli gjykatesja e Rennes...

pyetjeve te tjera, i pergjigjet se nuk kam komunikuar kure me te, nuk e kam takuar asnjehere, nuk e di etj.

- **Pyetja e bashke te pandehurit Fatmir Hajdini dt.20.08.2019. ky shtetas nuk ka pranuar te japi shpjegime.**

- **Pyetja e bashke te pandehurit Ilir Gashi dt.12.04.2019. nuk del asnje e dhene implikuese per Domart Konjarin.**

Pyetjes a e njihni shtetasin Domart Konjari, ai pergjigjet po e kam njohur ne shqiperi, e kisha komshi.

Pyetjes se a keni komunikuar me D.K, ai pergjigjet se nuk ka komunikuar kurre me te.

Pyetjes se a keni dijene per aktivitetin e paligjshem qe ka kryer Domart Konjari, ai pergjigjet se e di ka mediat shqiptare dhe franceze se ai ka kryer disa veprime te paligjshem.

Pyetjes A jeni ju , ai qe keni blere 25kg kokaine te gjetur ne makine qe ju drejtoni, ai pergjigjet JO.

Pyetjes Kush ju ka siguruar mallin, ai pergjigjet se eshte dikush me emrin Artan dhe se te gjitha pergjigjet u bene per Tanin.

**Nga pyetja e te gjithë ketyre bashke te pandehur dhe deshmitarve nuk del asnje fakt qe te implikoje shetasin Domart Konjari ne veprimtari te paligjshem, edhe ne nje rast ne pyetjen e bashke te pandehurit Davy Fraga, ai pergjigjet se keto te dhena i ka mare vesh nga**



**policia kur eshte arrestuar, pra ai s'kishte asnje dijeni dhe nuk jep dot asnje te dhene implikuese.**

Barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, duhet t'i krijojë gjykatës bindjen “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm” se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri.

Sipas Vendimit Unifikues Nr. 7 të datës 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: *“Për vendimin përfundimtar lidhur me themelin e akuzës, gjykata disponon bazuar në bindjen e saj mbështetur në prova që vërtetojnë ose jo akuzën, pra jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Asnjë provë nuk mund të ketë një vlerë të paracaktuar, si në drejtim të fajësisë ashtu edhe të pafajësisë”.*

Pra, në procesin penal, organit të akuzës i kërkohet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, çdo element që përbën veprën penale, për të cilën akuzohet i pandehuri.

Nga ana e tij, i pandehuri nuk ka asnjë detyrim që të provojë pafajësinë e tij, megjithatë, ai gëzon të drejtën të mbrohet në procesin penal, në përputhje me procesin e rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. Lidhur me standardin e vlerësimit të provave GJEDNJ, në çështjen Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë shprehet se: *“Për të vlerësuar provat e faktit, Gjykata adopton standardin e të provuarit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, por shton se prova të tilla duhet të ndiqen nga bashkëekzistenca e deduktimeve përkuese, mjaftueshmërisht të fortë dhe të qartë ose nga prezumime të njëjta e të pakundërshtueshme të faktit.”.*

## - VII -

- **Persa i perket akuzes per “Falsifikimi i leternjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” dhe “Korrupsionit aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike”.**

Ne lidhje me kete akuze deklarojme se i pandehuri Domart Konjari, ka qene i detyruar per te perdorur nje dokument te falsifikuar per te kaluar tranzit ne vendin e kombesise se tij sic eshte shqiperia per shkak se shteti shqiptar eshte i pasigurt per jeten e tij, pasi ka perfituar azil politik ne shtetin Francez kunder shtetit te tij.

Ne keto kushte, ka qene i detyruar per te kaluar tranzit per ne shtetin Grek duke perdorur dokumenta te falsifikuara per te shpetuar jeten e tij, e drejte kjo e mbrojtur dhe me konventat e permendura me siper qe mbrojne te drejtat e refugjateve.

- **Ne baze te K.Pr.Penale eshte percaktuar se:**

Neni 387

### Vendimi i pushimit të çështjes

*(Ndryshuar pika 1 dhe shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, date 30.3.2017)*

1. Kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë, sipas rasteve të parashikuara në shkronjat “c”, “ç”, “e” dhe “ë”, të paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi, ose kur vepra penale është shuar dhe i pandehuri nuk pretendon pafajësi, gjykata vendos pushimin e çështjes, duke treguar edhe shkakun.

Neni 388

### **Vendimi i pafajësisë**

1. Gjykata merr vendim pafajësie kur:

**a) fakti nuk ekziston ose nuk provohet se ekziston;**

b) fakti nuk përbën vepër penale;

c) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;

ç) vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose të dënohet;

**d) nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën që akuzohet;**

**e) fakti është kryer në prani të një shkakut të përligjur ose të një shkakut padënueshmërie, si dhe kur ekziston dyshimi për qenien e tyre.**

Per te gjitha keto sa permendem me siper, ne analize te faktit dhe dispozitave ligjore nderkombetare dhe kombetare, bazuar ne nenin 387 te K.Pr.Penale Gjykata Duhej të vendoste:

1. Pushimin e gjykimit te ceshtjes kunder te pandehurit Domart Konjari, pasi personi nuk mund te meret si i pandehur nga shteti shqiptar per shkak te statusit te tij se refugjatit ne shtetin Frances si azilant politik, dhe kete gje e ndalon Konventa e Gjeneves per Refugjatet e vitit 1951.

Ne qofte se gjykata nuk vendoste pushimin e ketij gjykimi atehere, ne baze te nenit 388 pika 1/a/d/e kjo Gjykatë duhej të vendoste:

2. Deklarimin e pafajshem te te pandehurit Domart Konjari, per akuzen e “*Trafikimit te lendeve norkotike*”, “*Pastrimi i produkteve te vepres penale*” “*Organizate kriminale*”, te parashikuara nga nenet 283/a/2, 287/a,334/1, pasi fakti nuk ekziston dhe se nuk provohet se i pandehuri ta kete kryer vepren penale, sipas nenit 388/1/a/d te K.Pr.Penale.
3. Deklarimin e pafajshem te te pandehurit Domart Konjari, per akuzen “*Falsifikimi i leternjoftimeve, i pasaportave ose i vizave*” dhe “*Korrupsionit aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike*” sipas nenit 331/1, 189, 244 te K.Penal, pasi fakti është kryer në prani të një shkakut të përligjur ose të një shkakut padënueshmërie ne baze te nenit 388/1/e te K.Pr.Penale.

**DOMART KONJARI**

Perfaqesuar nga Av.Alban Bengasi dhe Av.Elton Hyseni